

Nr. Prot. 027/B/17**VENDIM Nr. 977****Për****Fillimin e procesit të Konsultimit Publik të
'Draft Rregullore për Planin Kombëtar të Numeracionit
për Rrjetet e Komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës'**

Në mbështetje të neneve; nenit 3, paragrafi 1), nenit 10, paragrafët 4), 11) dhe 12), nenit 79, paragrafët 1) dhe 2), nenit 82, paragrafët 1) dhe 3) të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*); në referim të nenit 20 të Rregullores së Brendshme (*Ref. Nr.Prot.161/06*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga,

- 1) z. Kreshnik Gashi, Kryetar
- 2) z. Bahri Ademaj, Anëtar
- 3) z. Hazir Hajdaraj, Anëtar
- 4) z. Nijazi Ademaj, Anëtar
- 5) z. Shqiprim Pula, Anëtar

në mbledhjen e 16-të me radhë të mbajtur më datë 19 Shkurt 2017, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (*DKE*), nxjerr këtë;

V E N D I M

- I. Miratohet fillimi i Konsultimit Publik të dokumentit '**Draft Rregullore për Planin Kombëtar të Numeracionit për Rrjetet e Komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës**'.
- II. Procesi i konsultimit publik fillon më datë; **26 Prill, 2017** dhe përfundon më **25 Maj, 2017**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: "*Miratton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.*"

Më tutje, neni 10, paragrafët 11) dhe 12) të Ligjit përkufizojnë kompetencat e Autoritetit për miratimin e Planit Kombëtar të Numeracionit dhe menaxhimin e resurseve numerike në komunikimet elektronike.

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t'i publikoj ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Duke pasur parasysh faktin se Republikës së Kosovës më datë 15 Dhjetor 2016 i është caktuar kodi telefonik 383 së bashku me kodet tjera përcjellëse nga ITU, atëherë në përputhje edhe me Planin e Migrimit të miratuar nga ARKEP me Vendimin nr.935 (Ref. Nr.Prot.011/B/17) është paraqitur nevoja për rishikimin e Planit aktual të numeracionit.

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike;

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 25/04/2017

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet;

- Operatorëve (ndërmarrësve) të rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Departamentit Ligjor (DL),
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike (DKE),
- Arkivës së Autoritetit